



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

### RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Burim Guri</b>	<b>15.08.2025</b>	<b>19.08.2025</b>	<b>2025/0751</b>

#### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 07.08.2025, OE “AGRI BAU SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0751, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me mekanizem bujqesore”, me nr. të prokurimit: "641-25-6684-1-1-1", te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: 150,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

#### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

**Neni 1- Qëllimi**

**Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

**Neni 27- Dosja e Tenderit**

**Neni 28- Specifikimet Teknike**

**Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

**Rregullorja nr.001/2022 për Prokurimin Publik Neni 19 Specifikimet Teknike**

**(19.1 Në zbatim të Nenit 28 dhe 29 të LPP)**

**NEN-in 19.6 dhe NEN-in 19.4 te Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik**

Te pakenaqur me vendimin e datës 04.08.2025 mbi refuzimin e kërkesës tone per rishqyrtim nga AK-KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ ne lidhje me aktivitetin e prokurimit:"Furnizim me mekanizëm bujqësorë" nr. te prokurimit: 641-25-6684-1-1-1 ne afatin ligjor konform nenit 109 te LPP-së, prane OSHP-se ushtrojmë këtë:

### ANKESË

Me daten 30.07.2025 kemi ushtuar kerkese per Rishqyrtim tek AK lidhur me perpilimin e Dosjes se Tenderit pasi qe tek FTD dhe tek Paramasa jan vendosur kerkesa te cilat ndikojn direkt ne zvogelimin-eliminimin e konkureses ne mes te operatorve ekonomike e cila eshte qart e sanksionuar me ligjin e Prokurimit Publik.

Me daten 04.08.2025 AK ka marrur vendimin per Refuzim te kerkeses tone duke e konsideruar si te pabazuar duke mos e arsyetuar veq e veq asnjeren pike te pretendimeve tona. Vetem pretendimin nr. lidhur me kosen e motokultivatorit ka pranuar qe te largohet si gabim teknik. Me poshte gjeni pretendimet tona lidhur me kete aktivitet

#### Pretendimi yne nr. 1

*Tek dosja e tenderit; Kushtet dhe kërkesat e dërgesës 5.3, AK ka kerkuar; Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës; në 20 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës fillim përfundim.*

Ne i kemi sqaruar AK-se se ky afat eshte tejet i shkurter dhe ndikon direkt ne zvogelimin dhe eliminimin e operatorve ekonomik te cilat nuk posedojne kete lloj dhe kete nr. te pajisjeve ne stoqet e tyre, do te thote se favorizohet kompani e cila veqse i ka ne stoqe kete lloje te motokultivatorve dhe makinave mjelese, dhe ngre dyshimin se ky aktivitet eshte perpagtitur per kompani e cila ka ne stoqe kete lloj dhe kete sasi te motokultivatorve.

Po ashtu ne kemi informuar dhe besojme qe edhe AK jane ne dijeni se keto pajisje nuk prodhohen ne vendin tone, po edhe nese do te prodhoheshin nuk ka mundesi qe brenda 20 dite te prodhohen dhe te behet liferimi i tyre, dhe ne si OE kemi kerkuar qe afati i liferimit duhet te jete minimum 45 dite, sepse nuk ka asnje mundesi qe nje OE te beje ne kohe liferimin e pajisjeve perveq asaje kompanie e cila ka ne stoqe e qe ne mendojme se eshte pergatitur per kete tender.

AK me rastin e rishqyrtimit te kerkeses tone kishte marrur vendim qe afatin ta zgjase vetem per +5dite tjera pa dhene asnje arsyetim se qfar ndikimi mund te kete ne liferim +5dite do te thote total permbyllja e kontrates 25dite per nje aktivitet me nje vlere prej 150.000.00 euro.

Poashtu AK tek kerkesa per vlefshmeri te ofertes dhe sigurim tenderi ka kerkuar 3-4 muaj afat vetem per vleresuar kete aktivitet prokurimi do te thote se AK-se i duhet 3-4 muaj vlefshmeri tenderi vetem per te vleresuar tenderin, ndersa ne anen tjetër ka kerkuar qe brenda 25 dite te behet permbyllja e kontrates per pajisje te cilat nuk prodhohen fare ne Kosove.

#### Pretendimi nr.2

Ky pretendim i kerkeses per rishqyrtim veq se eshte pranuar ne kerkesen per Rishqyrtim dhe nuk eshte e nevojshme qe te elaborohet tutje.(vetem kemi evidentuar sipas nr.rendor te pretendimeve ne kerkesen per rishqyrtim)

3/5



### Pretendimi nr.3

Tek: Aneksi 1 **Specifikimet teknike**, LOT 2 AK ka kerkuar;

Nr	Modeli	Specifikat	Njesi	Sasia
1	Modeli I kultivatorit	Motorri dizell ose Gasoline	cope	40
3	Lloi I motorit	Një cilindër, 4 goditje, ftohje me ajër		
5	Fuqia e motorrit	6,7 HP		
6	<b>Kapaciteti I rezervuarit te karburantit</b>	<b>min 4.5L</b>		
7	Transpetimi I boshtit	Ingranazh, I Drejhtë		
8	Nderrimi I maresheve	min 2, -1,		
9	Gjersia e punimit	1050mm		
10	<b>Thellesia e punimit</b>	<b>10mm</b>		
11	Shpejsia e rotorit me motor ne	3600(r/min)		
12	Lloji I frezez	4-4 /32 copë		
14	Pesha neto	min 96 max 149		
15	Pllugu me nje krahe, pesha	Statik , 2kg		
16	Katalogu	Te dorzohet katalogu dhe te jete I verifikueshem ne web faqe per te gjitha specifikat e larte cekura.		

- Kapaciteti i Rezervuarit eshte caktuar min. 4.5L i cili rezervuar nuk korresponon me kapacitetin e motokultivatorit dhe kjo specifike e kufizon pjesmarrjen per shkak se per kete lloje te motokultivatorve standard kapaciteti i rezervuarit eshte 2.5L, prandaj ky kapacitet eshte jasht standardeve dhe eshte e pa nevojshme dhe jo relevante te percaktohet pasi qe AK ka vendosur fuqine e motokultivatorit, kapaciteti i rezervuarit do te duhej ti lihet prodhuesit ashtu siq jan standardet e prodhimit ne baze te kapacitetit te fuqise se motokultivatorit, apo te jete minimum 2.5L.

Po ashtu AK ka kerkuar qe per keto specifika te dorezohet katalog i cili duhet te jete i qasshem ne Web te prodhuesit me te gjitha specifikat dhe nuk ka lejuar qe te mundesohet nga OE nje deklarate per specifikime teknike se jan ne perputhje me kerkesen te cilat jan opcionale dhe nuk gjinden ne nje katalog standard ne web.

### Pretendimi nr.4

Tek: Aneksi 1 **Specifikimet teknike**, LOT 2, tek pika nr.10 e specifikimeve teknike per motokultivator AK ka kerkuar;

<b>Pika. 10</b>	<b>Thellesia e punimit</b>	<b>10mm</b>
-----------------	----------------------------	-------------

Thellesia e punimit **10mm (1cm)** eshte mjaft e vogel dhe ne nuk e dijm se a eshte gabim teknik apo ashtu eshte percaktuar prandaj kerkojme qe kjo specifike te rregullohet.

Edhe pse ne kerkesen per Rishqyrtim kemi kerkuar qe kjo specifike te ndryshohet sepse eshte gabim, sepse nuk ekziston dhe nuk mund te kete nje freze motokultivatori me thellesi punimi 10mm, AK ka refuzuar kete pretendim duke mos e sqaruar fare refuzimin ne kete pike.

Frezat standarde te motokultivatorve kan nje thellesi punimi minimum **100mm (10cm)**, dhe nuk mund te kete thellesi punimi 10mm (1cm).



### Pretendimi nr.5

Pika nr.16 te specifikimet teknike AK ka kerkuar;

Pika. 16	Katalogu	Te dorzohet katalogu dhe te jete i verifikueshem ne web faqe per te gjitha specifikat e larte cekura.
----------	----------	---

*Te nderuar, AK ka kerkuar nje katalog te verifikueshem ne web, dhe tek specifikimet teknike ka kerkuar specifika te cilat jane opsionale dhe disa prej tyre jashte standardeve te prodhuesve dhe nuk mund te jene te gjitha ne katalogun ne web te prodhuesit.*

*Prandaj me te drejt kemi kerkuar nga AK qe, katalogu perveq qe te jete i verifikueshem ne web te ipet mundesia qe per specifikime te cilat jan opsionale te mund te zotohemi me nje deklarate mbi specifikimet teknike nga OE ose nga prodhuesi per shkak qe disa specifikime qe ju keni kerkuar mund te mos figurojne ne katalogun standard te Prodhuesit mirpo ato mund te te prodhohen ne baze te kerkeses se juaj.*

*Prandaj kerkojme qe per kete pike te mundesohet deklarata nga OE ose prodhuesi per specifikime se jan ne perputhje me kerkesen e AK-se.*

### Pretendimi nr.6

Tek specifikimet teknike Lot 2 per makine mjelese AK ka kerkuar;

Makina duhet te kete nje rezervar 16L baker ose inox,

Te nderuar sa i perket rezervuarit te kerkuar me material baker nuk ka ne treg, mund te kete Alumin ose Inox, prandaj kerkojme qe edhe kjo te permiresohet, dhe te specifikohet materiali.

AK ne vendimin per refuzim te kerkeses per Rishqyrtim nuk ka dhene asnje arsytim per Pretendimet tona nr.3,4,5,6, mirpo refuzimin e ka bere vetem me fjaline;

*Pretendimet e tjera të Operatori Ekonomik **AGRIBAU SH.P.K.** i konsideron si te pa bazuar në kerkeses e për rishqyrtim për lëndën **Furnizim me mekanizëm bujqësorë** dhe merr vendim për refuzimin e saj.*

Mos arsyetimi nga AK i pretendimeve ne kerkesen per Rishqyrtim duke mos e marrur me seriozitet Pretendimet e lartcekura dhe duke mos arsyetuar Pergjigjet ne Pretendimet tona, eshte ne kundershtrim me ligjin mbi prokurimin publik pikerisht me **Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve** e po ashtu **Rregulloren dhe Udhezuesin per Prokurim Publik.**

Prandaj kerkojme qe keto kerkesa sipas pretendimeve tona te lartcekura te ndryshohen dhe te permiresohen ne dosjen e tenderit sepse ndikojne direkt ne zvogelimin-eliminimin e konkurences ne mes te operatorve ekonomike e cila eshte qart kundershtrim me ligjin e Prokurimit Publik

Pas gjithë asaj qe u tha me lart, ne kërkojmë nga Paneli shqyrtues i OSHP-se qe bazuar ne shpjegimet dhe dëshmitë e dhëna me lart te aprovoi ne teresi ankesën tone si te bazuar, te anuloje vendimin e dates 04.08.2025, dhe te kërkoj nga Autoriteti Kontraktues korrigjimin e Dosjes se Tenderit dhe specifikimeve teknike.

Me respekt

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**AGRI BAU SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me mekanizëm bujqësorë**” me numër të prokurimit: “**641-25-6684-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ**

## KRITERET PËR VLERËSIM

--

		<p><b>Kërkesat e përshtatshmërisë:</b></p> <p><b>Kërkesa 1</b> Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin. No. 05 L-092. LPP mund të shkarkohet nga <a href="http://krpp.rks-gov.net">http://krpp.rks-gov.net</a>.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p><b>Dëshmia 1</b> Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkohen nga tenderuesi të cilët ka ndër mend që t’ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të përshtatshimit të dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do të konfiskohet garancioni i sigurimit të ofertës dhe do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë. Dokumentet të cilat do të kërkohen si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon 1.Vërtetim të lëshuar nga gjykata apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, ( jo me e vjetër se 6 muaj para datës së dorëzimit të tenderit. 2.Një vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve dhe kontributeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së dorëzimit të tenderit. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjelle dokumentet të kërkuara në niken. 1 dhe 2 i ien te dreite</p>
--	--	--	---

			<b>sigurim te ofertës dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.</b>
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	<p><b>Përshtatshmëria profesionale</b></p> <p>a) Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit dhe numri fiskal ; (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës.</p> <p>b) Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore).</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>a) Kopja e certifikatës së regjistrimit te biznesit</p> <p>b) Kopja e certifikatës së TVSH-së</p>
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	<p><b>Kapaciteti ekonomik dhe financiar</b></p> <p>1. OE duhet te ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjate 3 viteve te fundit ka qene ne vlere, se bashku ne te tri vitet, prej jo me pak se 80,000,00 Euro për secilin Lot që konkuron.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>1. Deklaratat Tatimore vjetore te ATK për tri vitet e fundit.</p>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<p><b>Kapaciteti telnik dhe professional</b></p> <p>Për Lot 1 janë si në vijim</p> <p>1. Kompanit te cilat do te ofrojne oferta duhet te jen te Certifikuara me ISO standarde si Sistemi i Menaxhimit sipas ISO 45001 2018 dhe ISO 9001 2015 dhe ISO 14001 2015 dhe PAS 99. Certifikata duhet te jet ne Fushveprimi Ndertimi i Serrave dhe Produktet Bujqesore. Qertifikatat duhe te jene te leshuara nga kompani te cilat jane te besushme per qertifikim.</p> <p>2. Kompania ofertuese duhet te deshmoj qe ka inportuar foli si PRO-60 muje PRO60-D-200 mic diffused( UV+EVA+LD+IR+AF+AD)</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>1. Qertifikimi duhe te jete para aplikim te tenderit.</p> <p>2. ku duhe te dorzohen edhe deshm e prodhimit dhe dudi doganore i c kompania mund te ofron kete plastike.</p>

Numri i Prokurimit: "[shëno numrin]" – Titulli "[shëno titullin]"

		<p><b>Agronom Bujqesore I diplomuar ne Fakultetin e Bujqesise dhe I qertifikuara nga Ministrija e Bujqesi dhe Zhvillim Rurale nga MBPZHR.</b></p>	
		<p><b>Pajisjet minimale që duhet të ketë OE</b>  <b>Kamion për transport, pesha e ngarkesës min 5.0 t, me vinq ngarkues.</b>  <b>Makinë CNC ( WE67K-63T2500 BENDING MACHINE ) për formesimin e lamarines</b>  <b>Makinë PRESE ECENTRIKE CNC J21 CUTTING MACHINE APA60T,,për prodhimin e lidhëseve(nyjeve) të elementeve të serrave, me kapacitet presimi(shtypës) min 60 ton</b>  <b>Makinë ( sharre elektrike ) për prerjen e gypave.</b>  <b>Makine CNC LLaser per prerjen e gypave dhe pllakave te metalit.</b>  <b>Makina te kete dy pjese, per prerjen te gypave dhe per pllaka.</b>  <b>Makine linje per prodhimin e Ujmbledheseve ULLUKU sistemi me tel zig zak</b></p>	<p><b>Për pajisjet OE Duhet të prezentojë këto dokumente Për automjetet regjistrohen Dekleratat unike e faturat e blerjes, të gjitha ato mjete me fature të blerjes duhet bashkangjitur edhe dud-in doganor e bankes dhe deshmi qe paisjet makinerie per furnizim ( qe verteton se paisjet do te jene te instaluar per shfrytëzimin e realizimit te projektit). Për pajisjet regjistrohen ; Librezat e qarkullimit Në rast se OE-JA nuk posedon pronësin atëher OE-ja duhet të ofrojë për marrjen me qera të pajisjeve sipas kërkese me lartë, Marrveshje në emer të këtijë projekti në kohezgjatjes të këtijë projekti nën vulosur nga të dyja palët ,</b></p>

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Nuk ka raport të vleresimit, sepse ankese është bërë para hapjes së ofertave.

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

## VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - AGRI BAU SH.P.K.

**Sqarim hyrës:** Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Leposaviq ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titullin: “Furnizim me mekanizëm bujqësorë”, me numër prokurimi: 641-25-6684-1-1-1, procedurë e hapur, lloji i kontratës: furnizime. Autoriteti Kontraktues ka publikuar dosjen e tenderit në platformën E-Prokurim më datë 22.07.2025.

Operatori Ekonomik ankues, “AGRI BAU” SH.P.K., ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim në AK më datë 30.07.2025. Më datë 04.08.2025, AK ka nxjerrë vendim mbi refuzimin e kësaj kërkesë. Operatori Ekonomik ankues, i pakënaqur me vendimin e AK-së, ka paraqitur ankesë më datë 07.08.2025 pranë OSHP-së, duke kundërshtuar kriteret e vendosura në njoftimin për kontratë si dhe dosjen e tenderit të AK-së. Eksperti shqyrtues vlerëson pretendimet si më poshtë:

### **Përgjigjeje ne pretendimin ankimor Nr. 1:**

Operatori Ekonomik ankues pretendon se autoriteti kontraktues ne kriteret e vendosura te FDT-se, tek “Kushtet dhe kërkesat e dërgesës, pika 5.3, Afatet kohore për fillimindhe/osepërfundimekontratës ka kërkuar: në 25 pas nënshkrimit të kontratës”.

Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendimin ankimor si te bazuar, me arsyetimin se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar “fillimin dhe përfundimin e kontratës për 25 ditë, që të bëhet liferimi”. Rekomandimi ynë është që kjo pikë të korrigojohet dhe afati i liferimit të jetë **rreth 40 ditë kalendarike**, pasi qe konsiderojmë se afati i vendosur nga Autoriteti Kontraktues është i shkurtër për realizimin e furnizimit me pajisjet e kërkuara. Një afat i tillë, përveç që e vështirëson përmbushjen cilësore te kontratës, gjithashtu kufizon konkurrencën ne treg dhe mund të krijojë mundësi për favorizim të Operatorëve Ekonomikë të caktuar.

### **Përgjigjeje ne pretendimin ankimor Nr. 3, 4 dhe 5;**

### Pretendimi nr.3

Tek: Aneksi 1 **Specifikimet teknike**, LOT 2 AK ka kerkuar;

Nr	Modeli	Specifikat	Njesi	Sasia
1	Modeli I kultivatorit	Motorri dizell ose Gasoline	cope	40
3	Lloi I motorit	Një cilinder, 4 goditje, ftohje me ajer		
5	Fuqia e motorrit	6,7 HP		
6	Kapaciteti I rezervarit te karburantit	min 4.5L		
7	Transpetimi I boshtit	Ingranazh, I Drejhtë		
8	Nderrimi I maresheve	min 2, -1,		
9	Gjersia e punimit	1050mm		
10	Thellesia e punimit	10mm		
11	Shpejsia e rotorit me motor ne	3600(r/min)		
12	Lloji I frezez	4-4 /32 copë		
14	Pesha neto	min 96 max 149		
15	Pllugu me nje krahe, pesha	Statik , 2kg		
16	Katalogu	Te dorzohet katalogu dhe te jete I verifikueshem ne web faqe per te gjitha specifikat e larte cekura.		

Operatori Ekonomik, pretendon se AK ka bere kufizime dhe ne te njëjtën kohe diskriminime tek pozicionet 6, ku është kërkuar “Kapacitetit i rezervarit te karburantit min 4.5L”, pozicioni 10, ku është kërkuar “Thellesia e punimit 10mm”, dhe te pozicioni 16, ku është kërkuar “Katalogu, Te dorëzohet katalogu dhe te jete i verifikueshem ne web faqe per te gjitha specifikat e larte cekura”.

Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendimet ankimore si të bazuara, me arsyetimin se Autoriteti Kontraktues, lidhur me pozicionet e mëposhtme, ka vendosur kërkesa që kërkojnë rishqyrtim:

**Pozicioni 6:** AK ka kërkuar qe kapaciteti i rezervuarit te karburantit të jetë 4.5L. Rekomandimi ynë është që ky pozicion të korrigohet në një interval prej minimum 3L deri në maksimum 5L, për të lejuar më shumë konkurrencë dhe alternativa teknike në treg.

**Pozicioni 10:** AK ka kërkuar qe thellësia e punimit te jete 10mm. Rekomandimi ynë është qe kjo kërkesë te korrigohet në min.15cm – 25cm, sepse konsiderojmë se mund të jetë një gabim teknik në specifikim.

**Pozicioni 16:** AK ka kërkuar katalogë te verifikuar nga web-faqja per te gjitha specifikat e përmendura. Rekomandimi ynë është qe të kërkohen katalogë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, ose një deklaratë përkatëse që garanton aftësinë për të ofruar furnizimet e kërkuara, në përputhje me specifikimet teknike.

Rekomandojmë ynë qe Autoriteti Kontraktues te bëjë korrigjimin e ketyre pozicioneve dhe të veprojë

ne përputhje me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke krijuar hapësirë dhe mundësi sa më të gjerë për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë aktivitet të prokurimit.

### **Përgjigjeje ne pretendimin ankimor Nr. 6:**

Autoriteti kontraktues në kriteret e vendosura të FDT-se, tek Lot 2 - Furnizim me mekanizëm Bujqësor- Motokultivator me frezë, dhe pllug, si dhe makinë mjelese për lope qumeshtore, pozicioni 1 Makinë mjelese për lope qumeshtore, është kërkuar: “*Makina duhet të ketë një rezervar 16L bakër ose inox*”.

Operatori Ekonomik ankues, pretendon se AK ka bërë diskriminime dhe kufizime ku citon: “*Tek specifikimet teknike Lot 2 për makinë mjelëse, AK ka kërkuar: Makina duhet të ketë një rezervar 16L bakër ose inox. Të nderuar sa i përket rezervarit të kërkuar me material bakër nuk ka në treg, mund të ketë Alumin ose Inox, prandaj kërkojmë që edhe kjo të përmirësohet, dhe të specifikohet materiali. AK në vendimin për refuzim të kërkesës për Rishqyrtim nuk ka dhënë asnjë arsytim për pretendimet tona nr.3,4,5,6, mirpo refuzimin e ka bërë vetëm me fjalinë*”.

Eksperti shqyrtues analizon dhe vlerëson pretendimin ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se pajisjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues nuk mund të konsiderohen diskriminuese. Në këtë rast, AK ka kërkuar që rezervuari të jetë **prej bakri ose inoxi**, që do të thotë se është ofruar një alternativë e vlefshme lidhur me këtë specifikim teknik, ku edhe vet OE ankues ka potencuar se në treg mund të ketë pajisjes me rezervar Inox.

Eksperti shqyrtues, pas vlerësimit të disa pikave të pretenduara nga Operatori Ekonomik ankues, në lidhje me pozicionet e përcaktuara në specifikimet e dosjes së tenderit nga Autoriteti Kontraktues, konsiderojmë se ka bazë për ndërhyrje në disa prej tyre. Rekomandimi ynë është që Autoriteti Kontraktues të bëjë korrigjimin e pozicioneve të lartpërmendura dhe, njëkohësisht, të veprojë në përputhje me nenet 7, 51 dhe 52 të Ligjit për Prokurimin Publik. Gjithashtu, rekomandohet që të bëhet korrigjimi i njoftimit për kontratë dhe të zgjatet afati për dorëzimin e ofertave, në përputhje me afatet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

### **REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “AGRI BAU SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me mekanizëm bujqësorë” me numër të prokurimit: “641-25-6684-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL LEPOSAVOQ**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **AGRI BAU SH.P.K.**

**Burim Guri**

